



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
-AUTORITETI I KONKURENCËS-  
KOMISIONI I KONKURENCËS**

**VENDIM  
nr. 402, datë 23.02.2016**

**“Për  
dhënie vlerësimi mbi projekt/ligjin “Për mbrojtjen e sinjalizuesve”**

Komisioni i Konkurrencës, me pjesëmarrjen e:

- |           |             |            |
|-----------|-------------|------------|
| ▪ Lindita | MILO (LATI) | Kryetar    |
| ▪ Servete | GRUDA       | Zv/Kryetar |
| ▪ Koço    | BROKA       | Anëtar     |
| ▪ Iva     | ZAJMI       | Anëtar     |
| ▪ Eduard  | YPI         | Anëtar     |

Në mbledhjen e tij të datës 23.02.2016, shqyrtoi çështjen me:

**Objekt:** Për vlerësimin e projekt/ligjit “Për mbrojtjen e sinjalizuesve”

**Baza ligjore:** Neni 24, germa f), neni 69, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar)

**Komisioni i Konkurrencës** pasi mori në shqyrtim relacionin e Sekretarit të Përgjithshëm mbi vlerësimin e projekt-ligjit “Për mbrojtjen e sinjalizuesve”,

**VËREN SE:**

Autoritetit të Konkurrencës i është kërkuar mendim nga Kuvendi i Shqipërisë (Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut) për projekt/ligjin “Për mbrojtjen e sinjalizuesve”.

Nga vlerësimi i projekt/ligjit rezultoi se: Projekt/ligji ka për qëllim parandalimin dhe goditjen e korrupsionit në sektorin publik dhe privat, mbrojtjen e individëve që sinjalizojnë veprimet apo praktikatat e dyshuara të korrupsionit në vendin e tyre të punës dhe nxitjen e sinjalizimit të veprimeve apo praktikave të dyshuara të korrupsionit.

Për sa më sipër, duke vlerësuar projekt-ligjin “Për mbrojtjen e sinjalizuesve” në këndvështrimin e Ligjit nr. 9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar) konstatohet se ku projekt/ligj nuk sjellë kufizime dhe nuk bie në kundërshtim me parimet dhe rregullat e konkurrencës.

**PËR KËTO ARSYE**

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, germa d) dhe nenin 69, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, (i ndryshuar) me propozim të Sekretariatit,

## VENDOSI:

1. Projekt/ligjit "Për mbrojtjen e sinjalizuesve" nuk bie në kundërshtim me dispozitat e Ligjit nr. 9121 "Për mbrojtjen e konkurrencës" (i ndryshuar).
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Autoritetit të Konkurrencës për njoftimin e këtij Vendimi Komisionit Parlamentar për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut pranë Kuvendit të Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

## KOMISIONI I KONKURRENCËS

**Servete GRUDA**

(\_\_\_\_\_)  
**Zv/Kryetar**

**Koço BROKA**

(\_\_\_\_\_)  
**Anëtar**

**Iva ZAJMI**

(\_\_\_\_\_)  
**Anëtar**

**Eduard YPI**

(\_\_\_\_\_)  
**Anëtar**

**Lindita MILO (LATI)**

---

**K R Y E T A R**